



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:092756

Datë: 23.01.2025

Numri i dokumentit: 06748336

PKR.nr.438/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me anëtarët e trupit gjykues - gjyqtarët profesionist Alltën Murseli dhe Gëzim Ademi, me bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe zyrtaren ligjore - Dalina Kërçeli – Abdullahu - procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.P. , për shkak se në bashkëkryerje me V.P. ka kryer veprat penale: Vrasje në tentativë nga 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Kodi – 04/L-082 (në tekstin e mëtejme KPRK), e ri-kualifikuar sipas detyrës zyrtare në veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, lidhur me nën paragrafin 3.1 të KPRK-së – Kodi – 06/L-074 dhe Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, të evidentuar nën shenjë PP/I.334/2013, të datës 14 gusht 2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor – publik më 22 tetor 2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit D.H. , të akuzuarit D.P., mbrojtësit të tij sipas autorizimit avokat N.P. avokat në Prishtinë dhe të dëmtuarit – dëshmitarët F.T. dhe K.A., më 14 janar 2025 publikisht shpalli, ndërsa më 22 janar 2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D.P., nga i ati S. dhe nëna Q. (e vajzërisë I.), i lindur më ... në fshatin H..., Komuna e O..., me vendbanim në P..., lagja D... rruga: "A..H..", tani me vendqendrim në Gj....., me numër

personal të identifikimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i martuar, ka të përfunduar shollën e mesme, me profesion: shofer i autobusëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. I akuzuari D.P. më 31 janar 2013 rreth orës 07:30/h, në P... në rrugën para p.. k..., pikërisht në parkingun e p., derisa të dëmtuarit F.T. dhe K.A. ishin duke shkuar në punë në P., aty kishte dal i akuzuari D.P. me vëllaun e tij V.P. (i cili gjendet në arrati), ashtu që i akuzuari D. P. i kishte thënë të dëmtuarit F.T. “*ku je ti bre*” dhe me dashje të njëjtin e kanë goditur me mjet të rrezikshëm me shkop bejsbolli metalik nëpër kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i kanë shkaktuar ndrydhje të indeve të buta në kokë, në kraharor, në bërryla, në krahë dhe parakrah të djathtë dhe nën kërcinj, i kanë shkaktuar plagë shqyese nën mjekër dhe në kërcinj, gjak mbledhje nën lëkurore përreth syrit të majtë me sufuzion në konjunktivën e syrit dhe në regjionin e kofshës së djathtë si dhe thyerje të kockave të hundës, dhe më pas i akuzuari D.P. ka nxjerrë një revole ngjyrë të bardhë dhe me kondak e ka goditur disa herë të dëmtuarin F.T. nëpër pjesë të ndryshme të trupit, duke e rrëzuar në tokë, e me ç’rast të dëmtuarit F.T., i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe më pas V.P., ka ikur nga vendi i ngjarjes, ku më pas largohet nga vendi i ngjarjes dhe i akuzuari D.P. .

Me këtë i akuzuari D.P. në bashkëkryerje me V.P. (i cili gjendet ne Arrati) kanë kryer veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, lidhur, me nën paragrafin 3.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, lidhur me nenin 186 paragrafi 3, lidhur me nën paragrafin 3.1 të KPRK-së, si dhe neneve 276, 358, 360, 361, 362, 364, 367, 368, 369, 449, 452 dhe 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPPRK) të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 10,000.00 (dhjetë mijë) euro, të

cilin dënim i njëjti detyrohet t'a paguajë në afatin prej gjashtë (6) muajve, në këste të barabarta, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën në afatin e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

KONFISKOHET arma - shkopi i bejsbollit metalik, ashtu që detyrohet Policia e Kosovës pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të e bëjë asgjësimin e armës së lartcekur.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumat si vijon: për përpilimin e dy (2) ekspertizave mjeko – ligjore, shumën prej 20,00 (njëzet) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 200,00 (dyqind) euro, si dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimet, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e këtë nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Palët e dëmtuara F.T. dhe K.A., kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Konform nenit 362 paragrafi 1, nëparagrafi 1.3 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

II. Me datë, kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze i akuzuari D.P. në bashkëkryerje me vëllaun e tij V.P. (i cili gjendet në arrati), e kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarin K.A., duke e goditur shuplak në fytyrë dhe e kanë shtyrë të dëmtuarin duke e mbështetur për killindera të parkingut, ja kanë shkyer jaknen, e duke e goditur me shkop të bejsbollit në dorë, me ç'rast i kanë shkaktuar lëndime në pjesë të ndryshme të trupit, në kokë, në anën e majtë të nofullës së sipërme, në bërrylin e djathtë, të cilat paraqesin lëndime të lehta trupore me dëmtim të për kohshëm të shëndetit.

Me këtë i akuzuari D.P. në bashkëkryerje me V.P. (i cili gjendet ne arrati) kishin për të kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Për shkak se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

III. Me datë, kohe dhe vend të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i akuzuari D.P. në mënyrë të paautorizuar ka përdorur armën me qëllim të kërcënimit dhe frikësimit të të dëmtuarit K.A., në atë mënyrë që i akuzuari i lartcekur D.P. i është ofruar të dëmtuarit K.A. në një distancë prej 2-3 metra dhe e ka nxjerrë nga brezi revolen me ngjyrë të bardhë të përshkruar si në dispozitivin numër e parë të kësaj aktakuze dhe ia ka drejtuar të dëmtuarit K.A.

Me këtë i akuzuari D.P. kishte për të kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së

Për shkak se vepra penale është e përfshirë në Ligjin për amnisti, Ligji Nr. 04/L-209, më 11 Korrik 2013, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 39, më 19 Shtator 2013.

Shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, në raport me pjesën refuzuese, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Aktakuza

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë më 14 gusht 2014, ka deponuar aktakuzën të evidentuar nën shenjën PP.I.nr.334/2013, të datës 14 gusht 2014, kundër të akuzuarit D.P. për shkak se në bashkëkryerje me V.P. ka kryer veprat penale: Vrasje në tentativë nga 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së.

Shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë gjyqësor

Gjykata në kuadër të kompetencës territoriale dhe asaj lëndore më 19 shkurt 2016, ka caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, ku kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë. I akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë në raport me veprat penale që i janë vënë në barrë, për çka gjykata të njëjtin dhe mbrojtjen i ka njoftuar për të drejtat e tyre në raport me kundërshtimin e provave dhe kërkesat për hudhje të aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit Avokat N.P., brenda afatit ligjor (19 mars 2016) ka parashtruar parashtrësë për kundërshtim të provave dhe hudhje të aktakuzës.

Gjykata më 22 mars 2016 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin e dytë gjyqësor, ku kanë prezantuar të gjitha palët, në të cilin shqyrtim fillimisht prokurori i shtetit e ka bërë ri kualifikimin e veprës penale, sa i përket pikës III të dispozitivit të aktakuzës, nga vepra penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KPRK-së, në veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin e gjyqësor të lartcekur me aktvendim procedural e ka refuzuar kërkesën për kundërshtim të provave dhe hudhje të aktakuzës, ndërsa më 23 mars 2016 ka nxjerrë aktvendim të veçantë në raport me kërkesën e lartcekur, vendim ky i vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin nën shenjë PN.nr.238/16, të datës 01 prill 2016.

Shqyrtimi gjyqësor

Gjykata me datat 28 tetor 2024, 09 janar 2025 dhe 10 janar 2025, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimet gjyqësore publike në këtë çështje penale, ku kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë, e që i akuzuari përsëri ishte deklaruar jo fajtor lidhur me veprën penale.

Fjala hyrëse e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse kishte deklaruar aktakuza e prokurorisë është e mbështetur në prova dhe dëshmi të mjaftueshme të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat i kemi propozuar në aktakuzë, e të cilat do të administrohen në këtë shqyrtim gjyqësor ku do të vërtetohet se i akuzuari D.P. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.P., avokat A.C. në fjalën hyrëse kishte deklaruar se nga provat të cilat do të administrohen në shqyrtimin gjyqësor do të provojnë të kundërtën e asaj respektivisht të dispozitivit të veprës penale sepse të gjitha provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës dhe dëshmitarët e propozuar eventualisht e dëshmojnë se i mbrojturi im ka pasur një mosmarrëveshje ditën kritike me tani të dëmtuarin F.T. dhe lëndimet e shkaktuara janë nga një mjet respektivisht – shkop druri dhe assesi me armë që pretendohet se është goditur. Prova kryesore me të cilën do të duhej të provohej fajësia do të ishte arma, ku kjo provë mungon sepse i mbrojturi im nuk ka pasur fare armë dhe këto vetëm janë trillime të palës së dëmtuar. Andaj, në mungesë të provave ne besojmë gjykata do të merr aktgjykim lirues ndaj D.P.

Procedimi i provave personale

Gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave personale, përkatësisht me dëgjimin e të dëmtuarit - dëshmitarit F.T. cili ndër të tjera kishte deklaruar se ditën kritike ishte nisur për të shkuar në punë ... ngase aty ka punuar si zjarrfikës, gjatë rrugës e kishte marrë kolegun K.A., i cili në p.. kishte pozitën e sigurimit, ku në parkingun e p.., pasi kishte dalur nga vetura e kishte parë të akuzuarin D.P. (te hyrja e p.. - shkallët) ashtu që ende pa dalur nga rrethojat e parkingut kishte shkuar nga mbrapa vëllai i të akuzuarit D.P. i cili e kishte goditur nga mbrapa me stupc, diku ndërmjet krahëve dhe me një të goditur i njëjti ishte rrëzuar për toke e pastaj kishte shkuar edhe D.P. me allti në dorë duke e goditur me shkelma në trup, ku aty i ka humbur vetëdija dhe e kanë dërguar në spital, ku më pastaj i ishte kthyer vetëdija. Tutje ka shtuar se i akuzuari D.P. ka qenë i mbathur me llapqin dhe e ka goditur fytyrës, të njëjtit ia kishte parë revolen, që e kishte nxjerrë dhe e ka mbajtur në dorë. Ka shtuar se *me revole ka mundur të më vras por nuk ka dashur*, ka dashur vetëm të më rrah, sepse me më pas vra ka qenë në dijeni se i kishte marrë 15 vite burg dhe sipas meje *qëllimi ka qenë vetëm të më rrah*. Me kondak të revoles nuk kishte dijeni se a e ka goditur, sepse po t'a kishte goditur me kondak të revoles pa pasur diku gjak nuk kishte ndodhë dhe gjakderdhje kishte pasur vetëm në këmbë, e të cilin lëndim e kishte marrë nga stupci i bejsbollit dhe të dy këmbët i kishte pasur nga tre penj. Prej aso kohe ka probleme shëndetësore me astmën, ngase i kanë sjellur gjoksit. I akuzuari para ditës kritike e kishte telefonuar në mobil dhe fiks, ngase mobilin e kishte të ndalur, duke e kërcënuar e sharë dhe për këtë arsye e kishte lajmëruar rastin në Stacionin Policor në V... duke theksuar se nuk ka dijeni se cila kishte qenë arsyeja se përse ka ardhur deri te kjo ngjarje, të njëjtit nuk i kishte pasur borxh, por para i kishte huazuar një koleges N. F. (e cila ka bashkëjetuar me të akuzuarin aso kohe) dhe se e kishte parë se paratë ia kishte dhënë D. duke besuar se kjo ngjarje ka ndodhur për shkak të te hollave të cikat nuk ia kishte kthyer afro dy tre ditë, e që i njëjti ia kishte kërkuar paratë e tij.

I dëmtuari – dëshmitari K.A. ndër të tjera kishte deklaruar se më 31 janar 2013, aso kohe ka qenë në punë në P. e K.te objekti kryesor, ndërsa pozita i tij ka qenë punëtor i sigurimit. Personin F.T kishte njohur dy apo tre muaj para rastit, i njëjti po atë ditë (F.T.) e ka marrë tek Xh.. e Ll..., me veturën e tij dhe kanë shkuar në vendin e punë, pasi që janë parkuar në parkingun e p. kishte dalur i pari nga vetura më shpejtë sepse kanë qenë vonë, ndërsa F. ka mbetur duke e mbyllur veturën. Duke dalur nga parkingu aty e kishte vërejtur një person në krye të shkallëve që i kishte lidhur të dy duart dhe shikojke, dhe në atë moment e ka dëgjuar

një britmë mbrapa duke thënë “o K... më mbyti” dhe sa e ka kthyer kokën dhe ka shikuar nga mbrapa në anën e F., të njëjtin e kishte parë të shtrirë dhe një person duke sjellë në të, në atë moment që e kishte kthyer kokën nga F. ai personi që ka qenë në shkallë ka shkuar dhe e ka shtyrë, duke e mbështetur aty afër në gilindera i njëjti ishte larguar tre apo katër hapa dhe ka nxjerrë diçka nga brezi duke besuar që ka qenë revole sepse ia kishte parë tytën por krejt nuk e kishte parë sepse e ka pasur në dorë dhe i ka thënë largohu, në atë moment ka ardhur B.K. dhe i ka drejtuar me fjalët se dikush e mbyti F.T. I njëjti i kishte parë se i kanë rënë me shkelm te krahu – te qafa (ndoshta edhe në fytyrë) por edhe me dorë, duke mos ditur saktësisht se a i ka rënë me atë sendin apo revolen. Personi që ka qenë me stupc të bejsbollit i kishte sjellë më shumë, ndërsa për personin tjetër nuk e din sigurt por e din që i ka rënë një – dy herë. Pastaj i njëjti B. dhe N. e kanë marrë brenda të dëmtuarin dhe e kanë ulur në karrige, i cili kishte qenë pa vetëdije i kemi dhënë pak ujë dhe ka filluar për t’i ardhur vetëdija dhe pastaj ka ardhur ndihma e shpejtë për trajtim. Pas disa ditëve i njëjti e kishte kuptuar se problemi që kishte ndodhur kishte qenë tek një femër - kolege e tyre (e cila kishte punuar në p..) nga ka dëgjuar se me të njëjtën ka kaluar F., ndoshta ajo kishte qenë e atij personit që e kishte rrahur. Personi i cili e kishte shtyer me duar nuk kishte pasur qëllim për t’a sulmuar të njëjtin, por vetëm të e largojnë për të mos iu afruar F. Lidhur me rastin konkret ka dhënë deklaratë edhe në Polici dhe mbetet pranë asaj deklarate. I njëjti pas deklaratës së dhënë në këtë shqyrtim ka shtuar se nuk parashtrij kërkesë pasurore juridike duke kërkuar nga gjykata që të e liroj për shkak të vijimit në punë.

Dëshmitari B.K. gjatë shqyrtimit kishte deklaruar se ditën kritike më 31 janar 2013, përkatësisht në atë kohë kishte punuar në P. K. si menaxher i shërbimeve. Të njëjtën ditë ka shkuar nga shtëpia në p.. dhe në parking të p.. – tek parkingu kryesor kur ka arritur aty dikush i kishte treguar se F. është i rrahur dhe kur është afruar e kishte parë që F. ka qenë i shtrirë por i njëjti ngjarjen nuk e kishte parë. E kanë marrë të dëmtuarin dhe e kanë futur në objekt brenda p.. duke e ulur në karrige, pa dijeni nëse ka pasur vetëdije apo jo dhe ambulanca kishte arritur shumë shpejt, nuk kishte dijeni se nga kush ishte rrahur dhe se kamera nuk kishte pasur. Lidhur me rastin konkret ka dhënë deklaratë edhe në Polici dhe mbetet pranë asaj deklarate.

Dëshmitari N.B. ndër të tjera ka deklaruar se aso kohe ka punuar në P. K. si zyrtar për incidente te p.. që kanë ndodhur nëpër objekte, ka qenë në ndërrimin e natës që kanë përfunduar në mëngjes (në ora 08:00/h), ndërsa lidhur me rastin i konkret nuk kishte pasur njohuri, ngase kur kishte dalur nga puna e kishte parë një hallakam që kishte ndodhur dhe kishte vazhduar për në

banesë. Distanca nga e cila e kishte parë ngjarjen kishte qenë 50 -100 metër dhe se lidhur me rastin konkret ka dhënë deklaratë edhe në Polici

Procedimi i provave materiale

Në shqyrtimin gjyqësor janë administruar provat materiale si vijon: Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjëseneve, më 31 janar 2013, ekspertiza Mjeko - Ligjore e datës 29 janar 2013 për dy (2) të dëmtuarit F.T. dhe K.A. si dhe foto dokumentacioni.

Deklarimi i të akuzuarit

Gjykata ka vazhduar me deklarimin e të akuzuarit D.P. cili ndër të tjera ka theksuar se personin F.T. njeh ndoshta pesë ose gjashtë vite para se të ndodhë ky rast sepse ka punuar me ish gruan e tij. Të njëjtin e ka zënë në veturë me ish gruan N. F. (në muajin prill 2012) në P..., nga ka lindur konflikti dhe problemi i kësaj çështje. Këtë raport e ka vërtetuar ngase e ka përcjellë, nga telefonat, nga një fqinj i cili ka punuar në p.. si dhe vet gruaja e tij që ia kishte pranuar. Të njëjtin e kishte thirrur për t'u sqaruar ndërsa kishte pasur probleme me ish gruan dhe më 31 janar 2013, ishte ndarë me të njëjtën (pas 13 viteve martesë). Edhe pse nuk kishte pasur kurorë kishte bërë dasmë sipas traditave tona dhe kanë jetuar së bashku me të dhe prindërit e tij deri në ditën kritike. Herave të fundit F. kishte shkuar shpesh edhe te banesa. Ditën kritike kishte dalur për t'u sqaruar me të sepse i njëjti asnjëherë nuk i ishte lajmëruar në telefon, por dhe edhe kur i ishte është lajmëruar e kishte sharë. Kishte dalur vet para p... në ora 07:30/h, duke e pritur të dëmtuarin, kishte dalur prej veturës dhe ishte nisur në drejtim të p.. dhe në momentin që i dëmtuari e kishte parë i kishte thënë: “*a edhe këtu më ke dal a ...*” e kishte lënë dorën në brez, por nuk e di se a kishte pasur diçka. K. ka qenë dy hapa para tij, të cilin vetëm e kishte shtyrë me dorë dhe i kishte thënë largohu dhe F. e ka goditur me një shkop në krah dhe e di që e kishte goditur edhe një herë me grusht dhe ishte rrezuar dhe pastaj i kishte rënë me shkelma në këmbë, duar, nuk ka pasur qëllim për t'a lënduar në organe vitale a diku, po ashtu nuk ka pasur qëllim që t'a mbys por vetëm t'a rrah. Me stupc i ka rënë vetëm në shpinë dhe në këmbë, e më pas kur është rrëzuar e kishte goditur me këmbë edhe disa herë dhe e kishte pritur policinë deri sa kishte ardhur në vendin e ngjarjes, ishte larguar afro 20 metër nga F., ndërsa polica ka shkuar pas afro pesë minutave dhe i njëjti kishte shkuar në Stacion policor për të dhënë deklaratë, e të cilët e kanë njohur se F. e kishte lajmëruar disa herë gjoja se i njëjti e kishte kërcënuar. Policia e kanë kontrolluar dhe nuk kanë gjetur asgjë, përveç shkopit, telefonit dhe cigareve. Ka shtuar tutje se edhe po t'a kisha armën s'kam pasur se ku t'a fsheh sepse polica ka ardhur shumë shpejt dhe ka pasur frekuentim të madh të njerëzve ngase ishte vend publik. E gjithë kjo ka ndodhur për

shkak se i dëmtuari F. e ka prekur në moral (në familje) dhe si rezultat i kësaj ishte ndarë me ish gruan (më 31 janar 2013), është martuar para 3 viteve dhe jeton jashtë shtetit në Gj... Ka shtuar se ditën kritike nuk ka pasur revole dhe se lidhur me rastin është penduar sepse vetëm i ka shkaktuar vetit telashe.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare kishte deklaruar si vijon: me administrimin e provave dhe dëshmime gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari D.P. në bashkëkryerje me V.P. (i cili gjendet në arrati) ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Se i akuzuari kishte kryer veprën penale për të cilën është akuzuar është vërtetuar në mënyrë të plotë nga dëshmia e dëshmitarit F.T. e dhënë në prokurori dhe në këtë shqyrtim gjyqësor ku në mënyrë bindëse ka e përshkruar gjendjen faktike ashtu siç është cekur në aktakuzë e po ashtu gjendja e faktike e përshkruar në aktakuzë vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit K.A. e dhënë në shqyrtim dhe po ashtu dhe nga dëshmia e dëshmitari B.K.. Po ashtu gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë edhe vërtetuar edhe me administrimin e provave materiale. Andaj, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit për veprën penale në bashkëkryerje Vrasje në tentativë nga 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. Si rrethanë rënduese të merret parasysh mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale në vend publik para vendit të punës, i përgatitur paraprakisht për kryerjen e veprës penale dhe pasojën e shkaktuar tek të dëmtuarit F.T. dhe K.A.

I dëmtuari F.T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar si vijon: e përkrahi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe i bashkëngjitëm ndjekjes penale, kërkojë vetëm që të dënohet sipas ligjit por nuk kërkoj kompensim dëmi.

Mbrojtësi e të akuzuarit D.P. avokat N.P. në fjalën përfundimtare, ka deklaruar si vijon: nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i mbrojturi im ka kryer veprën penale ashtu siç është përshkruar në aktakuzë Vrasje në tentativë. Që nga fillimi i zhvillimit të hetimeve, e deri më tani edhe prokuroria nuk e provoj me prova kryerjen e kësaj vepre penale e që faktikisht i mbrojturi im ka kryer veprën penale të lëndimit trupor por jo të Vrasjes në tentativë që d.m.th. se mungojnë të gjitha elementet e figurës së kësaj vepre penale. Në këtë shqyrtim gjyqësor dëshmitarët e propozuar nuk kanë dhënë asnjë fakt në drejtim të veprës penale të Vrasjes dhe dëshmitë e tyre ishin irelevante. Provat si ekspertizat mjeko - ligjore provojnë se vetëm u janë shkaktuar lëndime trupore në

këmbë dhe trup, e jo në pjesë vitale për të cilat mund të rrezikohet edhe jeta e të te dëmtuarave. Në këtë shqyrtim gjyqësor i dëmtuari F.T. pranoj faktin se nga tani i akuzuari është goditur me shkelma në trup e veçanërisht lëndime më të rënda ka pasur në këmbë e që ka pasur edhe intervenime mjekësore e që nënkupton se këto janë lëndime trupore por jo në drejtim veprës penale të vrasjes. I dëmtuari ka deklaruar se qëllimi ka qenë për të më rrahur sepse po të kishin dashtë me më vra kanë mundur sepse kemi qenë në një afërsi të afërt dhe nuk kam pasur goditje në kokë sepse po të më kishin goditur me armë apo mjet të fortë do të kisha gjak në fytyrë dhe kjo vërteton se qëllimi i të mbrojturit tim ka qenë fillimisht për t'u sqaruar por pas eskalimit të situatës i ka shkakuar lëndime me një mjet të fortë, fillimisht e ka goditur një herë në krah, e ka rrëzuar në tokë dhe me shkelma e ka goditur në këmbë por asnjëherë në pjesë vitale si në fytyrë apo pjesë tjera të ndjeshme të trupit. Edhe dëshmitari K.A. ka deklaruar se është lënduar nga i mbrojturi im, ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe e ka parë ditën kritike të dëmtuarin kur i akuzuari e ka goditur vetëm me shkelma në trup. Këtu e sqaroi se i mbrojturi im ka kërkuar disa herë sqarim që të largohet nga bashkëshortja e tij, por i njëjti as që ka dashur që të dëgjoj dhe të merret me këtë, por për këtë rast i mbrojturi im tha se e ka parë vet që kanë pasur lidhje intime me ish bashkëshorten e tij, i ka parë telefonatat në mes tyre dhe ka dëgjuar edhe nga familjarët dhe shokët se i dëmtuari F., është duke ndërhyrë dhe prek në moral familjar, andaj edhe ka ardhur deri te kjo situatë - rast. Tani edhe vet ndihet i penduar sepse është edhe vet i dëmtuar ku edhe ka humbur bashkëshorten dhe janë ndarë. Kërkoj nga gjykata që në mungesë të provave t'a liroj nga akuza sepse nuk kemi elemente të veprës penale të Vrasjes në tentativë eventualisht, kemi vetëm veprime në drejtim të veprës penale të lëndimeve trupore dhe kërkoj nga gjykata që të nxjerr aktgjykim lirues.

I akuzuari D.P. në fjalën përfundimtare kishte deklaruar si vijon: e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

VLERËSIMI I PROVAVE

Rrethanat jokontestuese dhe kontestuese

Gjykata fillimisht konstaton se në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestues fakti i akuzuari D.P. dhe i dëmtuari F.T., para ditës kritike, kishin pasur një mos marrëveshje së bashku e cila lidhet me ish bashkëshorten jashtëmartesore të akuzuarit D.P., e cila aso kohe kishte punuar së bashku me palën e dëmtuar dhe se i akuzuari më 31 janar 2013, kishte shkuar në parkingun e

P.. K. në P., ku ka punuar i dëmtuari, duke e pritur të njëjtin me ç' rast e kishte goditur të njëjtin (F.T.) me mjet të rrezikshëm – shkop bejsbolli në pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasojë e goditjeve pala e dëmtuar e ka humbur vetëdijen dhe ka marrë trajtim mjekësor. Kontestuese në rastin konkret ishte rrethana se i akuzuari D.P. a kishte pasur qëllim që t' a privoj nga jeta palën e dëmtuar F.T. dhe se i njëjti ditën kritike a kishte qenë më vëllaun e tij V.P. (i cili gjendet në arrati)?!

Vlerësimi dhe analizimi i secilës provë si vijon:

Nga deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit F.T. gjykata ka provuar faktin se i njëjti ditën kritike ishte nisur për të shkuar në punë në P.. e K., i njëjti kishte qenë me kolegun K.A. dhe me të arritur të parkingu i p.. pasi kanë zbritur nga vetura e kishte parë të akuzuarin D.P. (te hyrja e p.. – te shkallët), ashtu që ende pa dalur nga rrethojat e parkingut kishte shkuar nga mbrapa vëllai i të akuzuarit D.P. – V. P., i cili e kishte goditur nga mbrapa me stupc, ndërmjet krahëve ku i njëjti ishte rrëzuar për toke e pastaj kishte shkuar edhe D.P. me allti në dorë duke e goditur me shkelma në trup, në gjithë trupin, ku i kishte humbur edhe vetëdija ku edhe është dërguar në spital dhe aty i ishte kthyer vetëdija. Sipas dëshmitarit, i akuzuari nuk kishte pasur për qëllim që të njëjtin të e privoj nga jeta, sepse i kishte të gjitha mundësitë, por vetëm që t' a rrah. Kjo pjesë e deklaratës për gjykatën ka qenë relevante duke e trajtuar si të sinqertë, pasi që gjen mbështetje edhe në prova tjera të cilat janë administruar gjatë këtij procesi gjyqësor.

Nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit K.A., gjykata ka arritur të vërtetojë faktin ditën kritike më 31 janar 2013, i dëmtuari F.T. kishte shkuar te Xh. e Ll., e kishte marrë me veturën e tij dhe kishin shkuar në vendin e punës në P.. ..., me të arritur të parkingu i njëjti kishte vërejtur një person (është fjala për të akuzuarin) në ato momente e kishte dëgjuar një britmë mbrapa duke thënë “o K... më mbyti” dhe me të kthyer kokën pas në anën e F. e kishte parë një person duke sjellur në të, i njëjti ishte larguar duke u ngjitur lart në krye të shkallëve, ku kishte shkuar edhe dëshmitari tjetër B.K. (i dëgjuar si dëshmitar në këtë çështje penale). Të njëjtit i kanë rënë me shkelm diku te krahu – te qafa ndoshta edhe në fytyrë dhe po ashtu i ka rënë edhe me dorë. Diçka ka pasur në dorë por nuk kishte dijeni saktësisht se a i ka rënë me atë sendin apo revolen dhe se F. ishte goditur me një stupc të bejsbollit, ka qenë i shtrirë në tokë pa vetëdije. Pastaj së bashku me B. dhe N. (dëshmitarët) e kanë marrë brenda objektit derisa ka arritur ndihma e shpejtë. Pas disa ditëve i njëjti e kishte kuptuar se problemi që kishte ndodhur kishte të bëjë me një kolege e cila kishte qenë në lidhje me të dëmtuarin F. dhe se personi që e kishte shtyer nuk kishte pasur qëllim për të e sulmuar të njëjtin, por për të mos e

lejë që ti afrohet F. Deklarata në fjalë për gjykatën ka qenë relevante, ngase e njëjta në detaje ka sqaruar rastin që ka ndodhur ditën kritike, e njëjta gjen mbështetje edhe në provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor për çka të njëjtës ia ka falur besimin e plot duke shtuar se deklarata në fjalë është identike me atë të dhënë më 28 janar 2014 në Prokurori.

Nga deklarata e dëshmitarit B.K. gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike i njëjti ka qenë duke shkuar në punë (P.. e Kosovës) dhe me të arritur tek parkingu ka marrë informatën se F. është rrahur dhe pasi që ishte afruar tek i njëjti e ka parë të shtrirë, ndërsa ngjarjen nuk e kishte parë. F. e kanë marrë dhe ulur në karrige brenda objektit të P.. dhe se ambulanca kishte arritur në ato momente. Kjo deklaratë nuk ka ndriçuar ndonjë detaj të panjohur për gjykatën (pos pozitës së palës së dëmtuar të shtrirë për toke pas sulmit që i kishte ndodhur nga i akuzuari), për faktin se i njëjti nuk ka qenë prezent në ato momente kur edhe është sulmuar pala e dëmtuar.

Po ashtu gjykata nga deklarata e dëshmitarit N.B. i cili aso kohe ka qenë duke punuar në P.. e Kosovës, nuk ka vërtetuar ndonjë detaj relevant pos asaj që ditën kritike më 31 janar 2013, i njëjti ka qenë në ndërrimin e natës dhe me të dalë para p..... e ka parë një hallakam.

Nga Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjëseneve më 31 janar 2013, është vërtetuar fakti se nga Stacioni Policor J. në P., nga i akuzuari D.P., është konfiskuar përkohësisht një (1) shkop bejzbolli metalik.

Nga ekspertiza Mjeko - Ligjore e datës 29 janar 2014 për të dëmtuarit F.T. dhe K.A., e përpiluar nga eksperti mjeko – ligjor Dr. F. B., gjykata ka vërtetuar faktin se në bazë të raporteve mjekësore në raport me të dëmtuarin K.A., ka dhënë mendim se: dëmtimet e përshkruara në gjetje – konstatim, paraqesin: ndrydhje të indeve të buta në kokë në anën e majtë të nofullës së sipërme, në bërrylin e djathtë e shoqëruar me gërvishtje të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit mbretes (jo i mprehtë) që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore. Këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Në bazë të raporteve mjekësore në raport me të dëmtuarin F.T. dëmtimet e përshkruara në gjetje – konstatim, paraqesin: Politraumë, ndrydhje e indeve të buta në kokë, në kraharor, në bërryla, në krah dhe parakrah të djathtë dhe në kërcinj, plagë shqyese nën mjekër dhe në kërcinj, gjak mbledhje nënlëkurore përreth syrit të majtë me sufuzion në konjunktivën e syrit dhe në regjionin e kofshës së djathtë, thyerje e kockave të hundës pa ç’vendosje fragmentesh, të vjellura 4-5 herë, ka marramendje dhe nauze. Këto dëmtime kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit mbretës (jo i mprehtë) që si të tilla së bashku bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Këto dëmtime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, shihet sendi i sekuestruar shklop bejzbolli metalik që vërtetohet se i akuzuari të njëjtin e ka përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

Rikualifikimi i veprës penale

Trupi gjykues pas vlerësimit të detajuar të aktit akuzues të parashtruar nga organi i akuzës – Prokurorisë si dhe provave të cilat janë administruar në këtë çështje penale juridike, e duke u bazuar në nenin 359 të KPPRK-së, me të cilën rregullohet identiteti subjektiv dhe objektiv i aktgjykimit me aktakuzën, gjegjësisht paragrafi 2 i nenit të lartcekur, ku është përcaktuar se: “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, në rastin konkret e ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike të përshkruar në dispozitivin e parë të aktakuzës, në raport me të akuzuarin D.P. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të provave personale (deklarata e dëshmitarit K.A.) dhe atë të deklaratës së të dëmtuarit – dëshmitarit F.T., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ka deklaruar se qëllimi i të akuzuarit D.P., nuk kishte qenë që të e privoj nga jeta, por vetëm t’u rrahur, ngase i njëjti po të kishte qëllim për të e privuar nga jeta, një gjë të tillë mund t’u kishte bërë lehtësisht, si dhe duke bazuar në ekspertizën mjeko ligjore të administruar më sipër, rezulton se dëmtimet që i janë shkaktuar të dëmtuarit F.T. kanë qenë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit mbretës (jo i mprehtë) që si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. Në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit nuk konsumohen elementet e veprës penale nga neni 178 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktit akuzues, për arsye se qëllimi i të akuzuarit nuk kishte qenë për t’u privuar nga jeta të dëmtuarin e lartcekur, vetëm të e rrah. Kjo për faktin se sipas nenit 178 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se: “*Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim*”, tutje neni 28 të Kodit të lartcekur parasheh institutin e Tentativës si dhe neni 31 të Kodit në fjalë rregullon atë të Bashkëkryerjes dhe në rastin konkret me veprimet e akuzuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë në bashkëkryerje. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, gjykata sipas detyrës zyrtare e ka ri kualifikuar veprën penale më sipër, në veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, lidhur, me nën paragrafin 3.1 të KPRK-së.

Aplikimi i Ligjit më të favorshëm

Gjykata duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2 të KPPRK-së, që rregullon Zbatimin e ligjit më të favorshëm, në mënyrën e përcaktuar si vijon: “*Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit*

të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”, në rastin konkret përkundër që vepra penale ka ndodhur më 31 janar 2013 dhe aso kohe zbatim ka gjetur Kodi Penal i Republikës së Kosovës - Kodi nr. 04/L-02, kjo gjykatë referuar dispozitës së lartcekur ka aplikuar – zbatuar dispozitat e Kodit Penal i Republikës së Kosovës - Kodi nr. 06/L-074, si ligj më i favorshëm për të akuzuarin.

Elementet e veprës penale

Gjykata ka analizuar dispozitën ligjore nga neni 186 të KPRK-së, më të cilën dispozitë është përcaktuar vepra penale Lëndimi i rëndë trupor, e përcaktuar si vijon: *“Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me 3.1.burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni”* ... tutje nenin 31 me të cilën dispozitë është rregulluar instituti i Bashkëkryerjes, ku është përcaktuar se: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”*.

Gjendja faktike e vërtetuar

Rrjedhimisht gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave personale dhe materiale, vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra - tjetrën, ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit D.P. konsumohen elementet e veprës penale të ri-kualifikuar nga gjykata. Në rastin konkret gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari D.P. dhe i dëmtuari F.T. para se të ndodhte konflikti fizik, kishin pasur një mos marrëveshje së bashku e gjithë kjo që ndërlidhet me ish bashkëshorten jashtë martesore të të akuzuarit D.P. e cila kishte qenë kolege e punës së palës së dëmtuar F.T., ashtu që më 31 janar 2013 rreth orës 07:30/h, në P.. në rrugën “D.. e K..” para p... k..., pikërisht në parkingun e p., derisa të dëmtuarit F.T. dhe K.A., ishin duke shkuar në punë në P., aty kishte dalur i akuzuari D.P. me vëllaun e tij V.P. (i cili gjendet në arrati), ashtu që i akuzuari D.P. së bashku me vëllaun, me dashje të njëjtin e kanë goditur me mjet të rrezikshëm me shkop bejsbolli metalik nëpër kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit, me ç’rast i kanë shkaktuar ndrydhje të indeve të buta në kokë, në kraharor, në bërryla, në krahë dhe parakrah të djathtë dhe nën kërcinj, i kanë shkaktuar plagë shqyese nën mjekër dhe në kërcinj, gjak mbledhje nën lëkurore përreth syrit të majtë me sufuzion në konjunktivën e syrit dhe në regjionin e kofshës së djathtë si dhe thyerje të kockave të hundës, dhe më pas i akuzuari D.P. ka nxjerrë një revole ngjyrë të bardhë dhe me kondak e ka goditur disa herë të dëmtuarin

F.T. nëpër pjesë të ndryshme të trupit, duke e rrëzuar në tokë, e me ç'rast të dëmtuarit F.T., i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe më pas V.P., ka ikur nga vendi i ngjarjes, ku më pas largohet nga vendi i ngjarjes dhe i akuzuari D.P. Këto veprime që ndërlidhen më të akuzuarin D.P. nuk janë mohuar gjatë këtij procesi as nga vet i akuzuari, përjashtimisht pjesës së armëmbajtjes, që i njëjti kishte mohuar se ditën kritike e kishte pasur armën në posedim, sepse kjo gjendje faktike është vërtetuar gjatë administrimit të provave personale dhe atë deklarata e të dëmtuarit F.T. si dhe të dëmtuarit K.A., përkundër që arma nuk është gjetur në vendin e ngjarjes. Mirëpo, gjykata në raport me këtë pjesë (armëmbajtjen) nuk është lëshuar në detaje lidhur në vërtetim të fakteve, për shkak se vepra penale nga dispozitivi i tretë i aktakuzës që e inkriminon të njëjtin lidhur me armëmbajtjen është e përfshirë në Ligjin për Amnisti, Ligji Nr. 04/L-209. Sa i përket lëndimeve të marra si më sipër pala e dëmtuar F.T. nga ana e të akuzuarit D.P., të njëjtat në mënyrë të detajuar janë përshkruar në ekspertizën Mjeko - Ligjore e datës 29 janar 2014 e përpiluar nga eksperti mjeko – ligjor Dr. F. B., provë e cila është administruar më sipër.

Se qëllimi i të akuzuarit D.P. kishte qenë vetëm për t'a rrahur e jo për t'a privuar nga jeta është provuar edhe nga deklarata e të akuzuarit në fjalë i cili kishte mohuar kategorikisht se intenca e tij kishte qenë të ja marrë jetën të dëmtuarit si dhe palës së dëmtuar i cili ndër të tjera ka theksuar se: *“qëllimi i të akuzuarit nuk kishte qenë për të më vrarë por vetëm për të më rrahur”*. Gjykata me kujdes ka analizuar situatën e këtillë në raport me privimin nga jeta dhe shkaktimin e lëndimeve nga i akuzuari, palës së dëmtuar, ashtu që marrë parasysh faktin se i njëjti me palën e dëmtuar ishin në një distancë të afërt, i akuzuari kishte poseduar mjet të fortë metalik (sipas dëshmitarëve të lartcekur edhe revole) një gjë të tillë mund t'a bënte lehtësisht, marrë parasysh edhe moshën e palës së dëmtuar, apo diferencën në moshë të palës akuzuese dhe palës së dëmtuar, ashtu që qëllimi i të akuzuarit kishte qenë vetëm sulmi ndaj palës së dëmtuar, duke i shkaktuar edhe lëndime të rënda trupore, si rezultat i konfliktit që e kishte pasur dhe se në rastin konkret i njëjti nuk kishte qenë vetëm në vendin e ngjarjes, përkundë që një fakt të këtillë e ka mohuar i akuzuari D.P., por me të kishte qenë edhe vëllai i tij V. P., fakt ky i cili është provuar nga deklarata e dy dëshmitarëve F.T. dhe K.A. të dhëna gjatë këtij procesi gjyqësor.

Vendimi i gjykatës për t'a shpallur të akuzuarin fajtor

Gjykata pas administrimit të të gjitha provave personale dhe materiale, në këtë çështje penale, duke e analizuar fillimisht secilën provë veç e veç dhe pastaj të gjitha së bashku, ka vlerësuar se me veprimet e lartcekura të të akuzuarit, konsumohen elementet qenësore të figurës së veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi 3, lidhur me nën paragrafin 3.1 të KPRK-

së dhe pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me deklaratimet e të akuzuarit

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes të shtuar deklaratat e të akuzuarit të dhëna gjatë stadi të parë të kësaj procedure penale si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, të njëjtave pjesërisht iu ka falur besimin pasi që kanë diskrepancë mes tyre. Deklarata e të njëjtit i cili ka sqaruar se me palën e dëmtuar kishin pasur mos marrëveshje që lidheshin me ish bashkëshorten e tij jashtëmartesore dhe se ditën kritike e ka sulmuar të dëmtuarin F.T. me mjet të fortë metalik qëndron ngase gjenë mbështetje në provat e administruara në këtë çështje penale si dhe fakti tjetër se i njëjti nuk kishte pasur qëllim që të dëmtuarin F. t'a privoj nga jeta, edhe ky fakt qëndron, ngase një gjë të tillë e ka pohuar edhe vet pala e dëmtuar F.T. Gjykata pjesës së deklaratës së të akuzuarit i cili mohon se ditën kritike kishte shkuar në vendin e ngjarjes së bashku me vëllaun e tij V.P. nuk qëndron, ashtu që të njëjtës nuk ia ka falur besimin ngase nga provat personale të administruara, përkatësisht dy deklaratat e të dëmtuarve, është vërtetuar një tjetër gjendje faktike, se i akuzuari D. kishte qenë ditën kritike me vëllaun e tij V. P. dhe se për gjykatën qëllimi i mohimi të këtij fakti nga i akuzuari, kishte për qëllim pozitën favorizuese në raport me ikjen nga përgjegjësia penale të familjarit të tij – vëllaut.

Vlerësimi lidhur me pretendimet e mbrojtjes të të akuzuarit

Gjykata me kujdes të shtuar ka analizuar edhe pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, e që për gjykatën të njëjtat kanë qenë të pranueshme.

Vendimi i gjykatës për pjesën refuzuese

Gjykata sa i përket pikës së dytë të dispozitivit të aktakuzës për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën veprë është paraparë dënim me burgim deri në tri (3) vjet, e cila pretendohet se është kryer më 31 janar 2013, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në kuptim të nenit 106 paragrafi 1, pika 1.5 lidhur me nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së.

Si përket pikës së tretë të dispozitivit të aktakuzës për veprën penale të ri-kualifikuar nga prokurori i shtetit në shqyrtimin e dytë gjyqësor të datës 22 mars 2016, në veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-

së, vepra është e përfshirë në Ligjin për amnisti, Ligji Nr. 04/L-209, më 11 Korrik 2013, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 39, në 19 Shtator 2013.

Vendimi mbi sanksionin penal

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë drejtim gjykata rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka gjetur se i njëjti i ka pranuar veprimet inkriminuese në drejtim të veprës penale të ri kualifikuar nga gjykata, sjelljen e tij korrekte gjatë këtij procesi gjyqësor si dhe pendesën në raport me kryerjen e veprës penale, ku tregon se i njëjti është ndjerë përgjegjës për veprimet e tij kundrejt palës së dëmtuar, çka tregon nivel të ndërgjegjësimit të te kuptuarit dhe reflektimit mbi sjelljet e tij në të ardhmen. Si dhe faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale, kanë kaluar afro 12 vjet. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale të te akuzuarit të kryer me dashje direkte dhe paramendim, si dhe mënyrën dhe rrethanat se si është kryer vepra penale duke shkaktuar rrezik për jetën dhe shëndetin trupor të te dëmtuarit. Duke i vlerësuar këto rrethana, përkatësisht me aplikimin e nenit 71 dhe 72 paragrafi 1, pika 1.4 të KPRK-së, ka bërë zbutjen e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor, ashtu që të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të mundësoj risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikoj edhe tek tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmoj në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, i cili është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të akuzuarin gjykata përveç rrethanave të cekuar ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të akuzuarin është i përballueshëm për kushtet ekonomike dhe të ardhurat që realizon i njëjti.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim, është marrë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, me të cilën dispozitë është paraparë se: “Nëse

personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim, njëzet (20) euro gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet”.

Vendimi për konfiskimin e armës - shkopit të bejsbollit metalik, është marrë konform 276 paragrafi 2, pika 2.2 të KPPRK-së, e cila dispozitë ka përcaktuar sendet që i nënshtrohen automatikisht konfiskimit, andaj kjo gjykatë edhe ka urdhëruar konfiskimin e sendit të lartcekur, si mjet që është përdorur për kryerjen e veprës penale.

Gjykata bazuar në nenin 457 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së, ku është përcaktuar se: “*Kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset me propozimin e personave të autorizuar në procedurën penale në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme ... Kërkesa pasurore juridike mund të përfshijë kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e një veprimi të caktuar juridik*”, palët e dëmtuara F.T. dhe K.A., i ka njoftuar për realizimin e kësaj të drejte, mirëpo të njëjtit kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në raport me pjesën dënuese është marrë konform nenit 452 paragrafi 1 të KPPRK-së, ndërsa lidhur me pjesën refuzuese vendimi në fjalë është marrë konform nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së. Vendimi në emër të kompensimit të Viktimave të Krimit është marrë, konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligjit nr.08/L-109).

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 dhe nenit 362 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.438/14, më 22 janar 2025

Zyrtare ligjore,
Dalina Kërqeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.